ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

ANKESË

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237,

Një ankesë kundër;Ministrsisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Aktivitetin e Prokurimit me numer të prokurimit; 208 Udhëheqesi-24 -5 645 -2-2-1

Sa i përket tenderit për; Shërbime të hotelerisë - bufesë ne objektin e MASHTI-t

1. IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK

Shqiponja BFB SHPK
(Adresa e OE)
Rr.Jashrajve nr 118 , Gllogoc
(Selia)
shqiponjabfb@gmail.com
Adresa elektronike)
Mehdi Malaj
(Drejtori)
16.08.2024
(Nënshkrimi) (Data)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Zyra e prokurimit të Ministrisë se Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit ne tekstin e mëtejmë do t' i referohemi si Autoriteti Kontraktues ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull te kontratës; Shërbime te hotelerisë - bufesë ne objektin e MASHTI-t.
Tenderi është publikuar ne Ueb faqen të KRPP-së në;

- Procedurë të hapur ,
- Numër të e-prokurimit: 208 Udhëheqesi-24 -5 645 -2-2-1
- Kontrate publike kornize, për 12 muaj
- Vlera e parashikuar e kontratës: 25,000.00
- Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,

Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve: data 25.06.2024 koha 13:00:00 vendi Në objektin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Prishtinë, nëpërmes platformës e-prokurimit .

Takimi për hapjen e tenderëve: data 25.06.2024 koha 13:00:00 vendi Në objektin e MASHTI-t, kati i III-të, zyra nr. 310 në Prishtinë, rr. Agim Ramadani pa nr.

Me date 05.08.2024 nëpërmes platformës se e-prokurimit është publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK-se (B58) ku AK ka propozuar OE D.P.H "Edukimi " për shpërblim te kontratës për periudhën prej 12uajve.
Me date 12.08.2024 kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim.
Me date 13.08.2024 kemi pranuar Vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] Jo [ ]

Hapja e tenderit është bere përmes platformës elektronike te E-prokurimit ne kohen e caktuar ne Njoftimin për kontratë.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

N/A

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për

Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

I pa kënaqur me Njoftimin mbi rezultatin e tenderit (B58) dhe në pajtim me 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092 , parashtrojmë këtë ankese kundër;

- **Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetet Kontraktues (B58)** te datës 05.08.2024 ku, AK ka propozuar për shpërblim të kontratës operatorin ekonomik; "D.P.H "EDUKIMI" rruga Agim Ramadani me vlerë totale të tenderit çmimi për njësi sipas peshimit % **23.90** euro.
- **Njoftimit për eliminimin nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit** (Letrës standarde për tenderues te eliminuar),
- **Vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim te AK-se**

Pretendojmë e se Autoriteti Kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje te dispozitave të;

I. **Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë konkretisht:**

- Nenit 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Nenit 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit dhe
- Neni 60 Kriteret për dhënie të kontratës

Në vazhdim të kësaj ankese do t' i argumentojmë pretendimet tona ankimore lidhur me shkeljet e dispozitave të;

1. ***Të dispozitave të LPP-se në RK.***

- **Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet që të shpërblej me kontrate tenderin e OE; "D.P.H "EDUKIMI" me adrese; Rruga, Agim Ramadani me vlerë totale të tenderit çmimi për njësi 54 euro, ka bere shkelje te dispozitave te nenit 6, paragrafin 1. dhe paragrafi 2, te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 6. paragrafi 1 dhe 2 te këtij ligji,

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Bazuar ne Vendimin e AK-se për rezultatin e tenderit i cili ka propozuar për shpërblim te kontratës, tenderin e OE ne vlere totale te çmimit për njësi prej 54 euro, si dhe bazuar ne tenderin e parashtruesit te kësaj kërkese (Shqiponja BFB Sh.P.K) cili ka ofertuar me çmim me te ulëte për njësi ne vlere prej 49.80 €, shohim qarte se AK, e ka dëmtuar buxhetin e AK-se dhe taksapaguesve te Kosovës dhe me këtë rast ka bere shkelje te dispozitave te nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 te LPP-se.

- **Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni 56 , paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:
1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Marrë parasysh faktin që Autoriteti Kontraktues, është i obliguar qe tenderin ta vlerësoj në pajtim me kriteret për kualifikim dhe përzgjedhje te OE te përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe ne dosje te tenderit si dhe Kriterin për dhënie te kontratës, si dhe ne pajtim me LPP, Rregulloren për Prokurimin Publik si dhe dispozitat tjera ligjore qe përcaktojnë objektin e kontratës (tenderit) ne rastin konkret dispozitat e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, si dhe bazuar ne Vendimin e AK-se për shpërblim te kontratës te cilin e ka propozuar me çmimin me te larte (DPH"EDUKIMI"), pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik, konformë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender si dhe kriterit për dhënie te kontratës, të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit dhe me këtë rast ka shkel nenin 56 të LPP-së.

- **Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,**

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij në ligji në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i operatorit ekonomik; DPH "Edukimi" i cili ka ofertuar me çmimin më të larte ne krahasim me parashtruesin e kësaj kërkese (Shqiponja BFB) , ka vepruar ne kundërshtim te nenit 59 duke shkel dispozitat e LPP-se dhe dispozitat e Ligjit Nr 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar si dhe kriterin për dhënie te kontratës i cili ne dosje te tenderit ka qen i caktuar Çmimi me i ulte i tenderit te përgjegjshëm si dhe duke aplikuar gabimisht dispozitat e Ligjit mbi Tatimin ne Vlerën e shtuar (TVSH) .
Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni nenin 59 te LPP-se ne momentin kur ka marre vendim për eliminimin e OE: Shqiponja BFB SH.P.K si dhe duke shpërblyer me kontrate OE ;D.P.H "Edukimi " i cili ka dorëzuar tender te pa përgjegjshëm ne kuptim te dispozitave te LPP-se, ndërkaq ka eliminuar OE ne këtë rast parashtruesin e kërkesës për rishqyrtim i cili ka ofruar dëshmi dokumentare mbi plotësimin e te gjitha kërkesave për kualifikim dhe pjesëmarrje ne tender te cilat jen te përcaktuara ne paragrafin; III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional te Njoftimit për kontrate dhe paragrafin III.2.4 (kapaciteti teknik/profesional si dhe ka respektuar kriterin për dhënie te kontratës i cili është Çmimi më i ulte i tenderit te përgjegjshëm.

Ne vijim do te përpiqemi qe t' i argumentojmë pretendimet tona, dhe atë si në vijim;

a) Pretendimi numër 1 i AK-se.

Ne letrën standarde te tenderuesit te eliminuar AK ka arsyetuar vendimin për eliminim nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se;

Eliminimi i ofertës tuaj është bere për shkak te gabimeve ne para masë.
Ju, keni plotësuar para masën duke vendosur shumen 18% te TVSh-se ne secilin pozicion te saj, duke mos e përshkallëzuar TVSH-ne, ashtu siç e parasheh Ligji 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Ne disa produkte baze si te qumështit, miellit etj. është dashur te vendoset shuma 8% TVSH-së, e jo 18% siç e keni përshkruar ju. Ne baze te kësaj qe u cek me larte konsiderojmë se oferta juaj është€ e pa përgjegjshme sipas Ligjit për prokurimit publik.

b)- Sqarim lidhur me pretendimin e AK-se;

Bazuar në dispozitat e Ligjit, Nr 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar shohim qarte se OE i propozuar për kontrate ka aplikuar gabimisht dispozitat e Ligjit duke ofruar normën e tatimit për shërbimet 8% te cilat te rubrika emri i prodhuesit ka deklaruar se është vet D.P.H "Edukimi" si dhe ka aplikuar gabimisht normën ne vend te shërbimit ka aplikua normën për furnizim.

Në vijim citoj dispozitën e nenit 26 të Ligji mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar;

Neni 26
Norma

1. TVSH ngarkohet me normën standarde prej tetëmbëdhjetë përqind (18%).
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni Norma e reduktuar në TVSH llogaritet dhe paguhet prej tetë përqind (8%) për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe importit të tyre, si në

vijim:
2.1. furnizimi me ujë, përveç ujit të ambalazhuar;
2.2. furnizimi me energji elektrike, përfshirë shërbimet e transmisionit dhe distribuimit, me ngrohje qendrore, mbledhjen e hedhurinave dhe trajtimin e mbeturinave tjera;
2.3. drithërat sikurse janë elbi, misri, varietetet e misrit, tërshëra, thekra, orizi dhe gruri;
2.4. prodhimet e bëra prej drithërave për qëllim të konsumimit njerëzor, sikurse janë mielli, brumërat, buka dhe prodhime të ngjashme;
2.5. vajrat për gatim të bërë nga drithërat apo farërat vajore për përdorim në gatim për konsumim njerëzor;
2.6. qumështi dhe produktet e qumështit me qëllim për konsumim njerëzor;
2.7. kripa e përshtatshme për konsum njerëzor;
2.8. vezët për konsum;
2.9. librat shkollore dhe publikimet serike;
2.10. furnizimi duke përfshirë huadhënien e librave nga bibliotekat, përfshirë broshurat, fletëpalosjet dhe materialet e ngjashme të shtypura, librat me fotografi për fëmijë, librat për vizatim dhe ngjyrosje, librat e muzikës në formë të shtypur apo të dorëshkrimit, hartat dhe grafiqet hidrografike dhe të ngjashme;
2.11. pajisjet e teknologjisë së informacionit;
2.12. furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, instrumenteve dhe aparateve mjekësore dhe kirurgjike;
2.13. pajisjet mjekësore, autoambulancat, ndihmat dhe aparatet tjera mjekësore me qëllim që të lehtësojnë ose trajtojnë paaftësinë për shfrytëzim ekskluziv të të paaftëve, duke përfshirë riparimin e këtyre mallrave dhe furnizimin e ulëseve të fëmijëve për vetura;
3. Ministri i Financave mund të nxjerr akt nën-ligjor për zgjerimin e listës së produkteve me normë të reduktuar sipas Shtojcës III të këtij ligji, ose reduktimin e listës së produkteve me normë të reduktuar.

Ne vijim te kësaj kërkese për ilustrim do te bazohemi ne Ofertën financiare te OE;D.P.H " Edukimi" i cili ka aplikuar gabimisht dispozitat e Ligjit mbi TVSH përkitazi me normën e TVSH -se ;

1. Te pozicioni nen; **A-Pije te ftohta dhe te nxehta** te emërtimi i artikujve ne numrin rendor11- Qumësht me çokolatë (bambi) produkt i prodhuar nga DPH Edukimi ka aplikua gabimisht normën e TVSH-se prej 8% ne vend te normës prej 18%, pastaj te pozicionet nen **B-Ushqim i nxehët dhe i ftohtë** tek artikujt nen numrin rendor 1, 2, 7, 8, 9, 10,11, pastaj 14,15,16,17, 18,19 dhe 20,te emërtuara si artikuj ushqim i nxehtë ka aplikuar gabimisht normën e tatimit te TVSh 8% ne vend te normës 18%.

Bazuar në nenin 26 të Ligjit si dhe bazuar në Specifikimin e çmimit te OE: D.P.H "Edukimi" shohim qarte se Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka bere shkelje te dispozitave te Ligjit nr 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar si rrjedhojë e kësaj Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te dispozitave te nenit 59 te LPP-se.

- **Neni 60 Kriteret për dhënie kontratës,**

Pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate një OE i cili është rekomanduar për shpërblim te kontratës dhe ka ofruar çmimin me te larte ne vlere prej totale te çmimit për njësi prej 54 euro ne krahasim me çmimin e ofruar nga

parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim i cili ka ofruar çmimin me te ulte ne vlere total të çmimit për njësi prej 49.80 €, dhe është eliminuar, ka bere shkelje te dispozitës se nenit 60 te LPP-se , duke mos respektuar Kriterin për dhënie të kontratës i cili ka qen i përcaktuar ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit; Çmimin më të ultë, i tenderit te përgjegjshëm.
Citoj dispozitën e nenit 60 te LPP-se;

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:
1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara si dhe dispozitat e nenit 60 te LPP-se pretendojmë se AK ka bere shkelje te dispozitave te këtij neni me rastin e marrjes se Vendimit për dhënie te kontratës për OE i cili për nga çmimi është më të lartë

PERFUNDIM

Marre parasysh faktet e lartshënuara kërkojmë nga paneli i OSHP që pas administrimit të fakteve dhe provave tëe marre;

VENDIM

- **TE APROVOJ,** Ankesën e operatorit ekonomik " Shqiponja BFB" SH.P.K si të bazuar të
- **TE ANULOJ** , Njoftimin mbi Vendimin e AK-se, të datës 05.08.2024 mbi rezultatin e tenderit (B58) ku është propozuar për shpërblim të kontratës OE:DPH" EDUKIMI"
  TE KTHEJ TENDERIN NE RIVLERESIM, dhe ri-vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret për dhënie kontratës, LPP-ne, Rregulloren nr001/22 për Prokurimin Publik, dhe Ligjin mbi Tatimin për Vlerën e Shtuar dhe ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

Mbetemi me shpresë se ankesa e jone do të shqyrtohet, pozitivisht.
Me nderime,
Mehdi Malaj
Drejtor

7. Dëmet materiale
Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri më tani dëme materiale ne vlere prej 500 euro për përgatitjen e Kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës.

8. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin mbi vendimin e AK-se " (B58)
c) një kopje të "Procesverbalit të hapjes publike të tenderëve"
d) një kopje te Kërkesës për rishqyrtim
e) një kopje të Vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim